



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR PRIVATIZIMIN

Nr. 2845 Prot.

Koplik, më 28 09.2022.

NJOFTIM

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore“, VKM-së nr. 179, datë 26.2.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe nr.31, datë 29.07.2022 “ Për miratimin e fillimit të procedurave për privatizimin e 5 apartamenteve në Qënder të qytetit Koplik“ si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe nr.64, datë 21.07.2022 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për privatizimin e 5 apartamenteve në qëndër të qytetit Koplik“,

1. Njoftohen të gjithë qytetarët të cilët posedojnë banesa ose objekte të kthyera në banesa të ndërtuara nga shteti, të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit, të ndodhura në qënder të qytetit Koplik të paraqesin brenda **60 ditëve** kërkesën për fillimin e procedurave të privatizimit të banesave pranë Bashkisë Malësi e Madhe.
2. Kërkesa duhet të paraqitet nga :
 - 2.1- subjekti i pajisur me autorizim nga organet kompetente ose, në rast vdekjeje, të trashëgimtarëve të tij; ose
 - 2.2- çdo person i autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar më lart.
3. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:
 - 3.1- të dhënat personale të subjektit kërkues,
 - 3.2- të dhënat lidhur me banesën ose objektin e kthyer në fond banese, për të cilin kërkohet privatizimi;
 - 3.3- datën e kërkesës e nënshkrimin e kërkuesit.
4. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

4.1- kontrata e qirasë, akti i dhënies ose i marrjes në dorëzim të banesës nga ish-ndërmarrja komunale banesa ose autorizim nga ish-organet administrative publike që e kanë strehuar në atë banesë;

4.2- certifikatë e gjendjes familjare e datës 1.12.1992 dhe certifikatë aktuale të gjendjes familjare në momentin e privatizimit

4.3- dëshmi e trashëgimisë, nëse subjekti i pajisur me autorizim ka ndërruar jetë.

ç) procure nëse personi është ngarkuar për të kryer veprimet nga subjekti i pajisur me autorizim.

d) dokument identifikimi i kërkuesit (kartë identiteti dhe/ose pasaportë biometrike).

5. Subjekti humbet të drejtën për të kërkuar privatizimin e banesës, në të cilën është strehuar, kur:

5.1- nuk depoziton kërkesën;

5.2- nuk depoziton dokumentacionin e përcaktuar në këtë njoftim;

5.3- refuzon që të paguajë vlerën e privatizimit të banesës ose të objektit të kthyer në banesë.

I gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet origjinal ose fotokopje i noterizuar.

KRYETARI I BASHKISË

TONIN MARINAJ

